

AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË “MILANO BEAUTY ACADEMY” SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

- 1.1 Shoqëria “MILANO BEAUTY ACADEMY” SH.P.K. themelohet nga Ortaku i vetem:
Z. Massimo Bonomi, shtetas italian, lindur më 05.08.1965 ne Verona (VN), Itali, rezidente ne Castiglione delle Stiviere (MN) Itali, mbajtes i Pasaportes me YA4186382, e leshuar me 11.03.2013 dhe e vlefshme deri me 10.03.2023, me zotesi te plote per te vepruar,

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “MILANO BEAUTY ACADEMY” SH.P.K.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).
5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Besim Alla, Pallati Alfa, Hyrja 4, Zyra nr.14, Njesia Administrative nr.14, Tirane
6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Tregti te aparaturave estetike per parukeri, palestra, spa dhe qendra estetike.
- Ndërmjetësim dhe orientim tregu per investime te reja ne Shqiperi. Asistence per konsulence fiskale dhe ligjore per te trete.
- Rekrutim dhe menaxhim burimesh njerezore per llogari te vet dhe te te treteve.
- Trajnim dhe formim profesional per perdorim te aparaturave estetike.
- Mirembajtje teknike per aparaturat estetike.

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 ALL (njqind mije leke)
- 9.2 Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë.
- 9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaku i vetem.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.

10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 11

Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakut te vetem te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakut te vetem raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e ortakut të vetëm

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakut te vetem.

13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakut te vetem përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.
- Vendimarrjen per investime te reja ne fushen e pasurive te paluajtshme brenda apo jashte territorit shqiptar.

Neni 14

Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

14.3 Administratori i shoqërisë është **Z. Massimo Bonomi, shtetas italian, lindur më 05.08.1965 ne Verona (VN), Itali, rezidente ne Castiglione delle Stiviere (MN) Itali, mbajtes i Pasaportes me YA4186382, e leshuar me 11.03.2013 dhe e vlefshme deri me 10.03.2023, me zotesi te plote per te vepruar,**

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtarinë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashte saj tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
 - Të hape dege ose zyre perfaqesimi, qe konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 15

Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përrputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përrjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përrfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i vetem dhe duhet të përrgatitet përr t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përrkatës. Përr operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Përr këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë përr realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përrputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Përr Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërrmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përrgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likujdimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem.

18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë përrçedurat e likujdimit.

18.3 Likujdatori do të përrgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përr përrfundimin e tij. Në përrfundim të kësaj përrçedure, Asambleja e Ortakut te vetem do të shqyrtojë bilancin përrfundimtar dhe do të miratojë përrfundimin e përrçedurave të likujdimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 23.10.2022

ORTAKU I VETEM:

Z. Massimo Bonomi

MASSIMO BONOMI

